



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-470/03-83251/23 më 26 APR 2023

Në bazë të neneve 13 dhe 26 të Ligjit nr.03/L- 040,për vetëqeverisje lokale ,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,nr.28/15,qershor 2008),të nenit 20 të ligjit nr.06/L- 021,për kontrollin e brendshëm të financave publike ,te nenit 4 të udhëzimit administrativ nr.01/2019,për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik ,të nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.Nr.110 -391 te dt 25.2.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** vendimi për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të auditimit për Komunën e Prishtinës.
- II. Komitetin e Auditimit të Brendshëm nga pika 1 e këtij Vendimi e përbëjnë:
 1. Rita Hajzeraj -Beqaj, Kryesuese;
 2. Visar Berisha, Anëtar dhe
 3. Milaim Peci , Anëtar.
- III. Drejtori i Njesisë së auditimit të brendshëm do të jetë sekretari i komitetit të cekur në pikën I të vendimit, në cilësinë e përcjellësit të takimit të Komitetit.
- IV. Mandati i anëtareve të Komitetit të auditimit të cekur në pikën II të këtij vendimi është tre (3)vjeçarë, më të drejtë riemërimin dhe për një mandat tre(3) vjeçarë.
- V. Detyrë e komitetit të cekur në pikën I të këtij Vendimi është: ofrimi i këshillave të menaxhmentit për KBFP, të sigurojë që menaxhmenti i SSP-së realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore, të rishikojë dhe aprovoj planet vjetore të NJAB, të rishikojë raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, deklaratat financiare, përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ndritura nga auditimi i jashtëm, të mbrojnë pavarësinë funksionale të NJAB dhe detyra tjera të parapara nga pikat 1.9 deri te pika 1.14 të nenit 4 të Udhëzimit administrativ.
- VI. Komiteti i auiditimit të përgatit raportin vjetor për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik,Raporti duhet të përfshijë pjesët e parapara nga pika 1.1 deri te pika 1.7 të nenit 7 të udhëzimit administrativ nr.01/2019.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
- VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi i Kryetarit të Kryeqytetit 14-020/04-00533579/18 i dt.06.08.2018.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të Komitetit;
- Drejtorit të NJAB dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë



KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përpajim Rama